

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GULIPOVA			
GULIPOVA MUNICIPALITY			
Pranuar	16 - 03	2020	
Ni. Org.	Numër	Shënjë	Markë
01 -	060 -	13533	

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURINË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: <u>12.03.2020</u>
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 2
<u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak ____ <u>Takim i jashtëzakonshëm</u> / Vanredni sastanak <u>X</u>
Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>15</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☐ Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku? Po / Da ☒ <i>KFOR-LMT K15.</i> Jo / Ne ☐ <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju</i>
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik? Po / Da ☒ Jo / Ne ☐
Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu: Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës: 1. Njoftim për masat e ndërmarra nga Komuna e Drenasit për mbrojtje nga virusi COVID-19 pas vendimit të djeshëm të Qeverisë dhe pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve të Komunës së Drenasit; 2. Të ndryshme.

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Fillimisht Kryetari Lladrovci hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, pastaj hedhi në votim rendin e ditës. Rendi i ditës u aprovua dhe nuk pati propozime për të ndryshme.

Në këtë mbledhje të jashtëzakonshme është diskutuar për masat e ndërmarra nga Komuna e Drenasit për mbrojtje nga virusi COVID-19 pas vendimit të djeshëm të Qeverisë dhe pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve të Komunës së Drenasit.

Në takim morën pjesë anëtarët e kësaj trupe për siguri, Kryetari i Komunës që është edhe kryesues i KKSB-së, Ramiz Lladrovci, Drejtoresha e DShPE-së, Lumnije Krapci, Komandantja e Stacionit Policor në Drenas, Feime Bajrami, përfaqësuesi i Bashkësisë Islame, përfaqësuesi i Komunitetit Katolik, koordinatori i KKSB-së, përfaqësuesi nga FSK-ja, përfaqësuesi nga Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi, përfaqësuesja nga OJQ-të, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, përfaqësuesi nga komiteti i biznesit, përfaqësuesja nga mediat, përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, drejtori i DKA-së, përfaqësuesi i KLSP-së në Komoran dhe përfaqësues nga KFOR-i.

Kryetari Lladrovci i njoftoi të pranishmit për vendimet e marra sot gjatë mbledhjes së jashtëzakonshme të bordit të drejtorëve, ku ndër të tjerash u mor vendim për formimin e Shtabit Emergjent, i cili përbëhet nga të gjithë akterët relevant në Komunën e Drenasit, të cilët do të përkujdesen për marrjen dhe zbatimin e masave preventive ndaj virusit COVID-19 (Koronavirusi).

Gjithashtu, kryetari Lladrovci, sqaroi se thirrja e vonë e mbledhjes së djeshme të Qeverisë dhe mënyra e marrjes së vendimit ka shkaktuar panik tek qytetarët të cilët kanë krijuar radhë në dyqane. Andaj, me këtë rast, i njoftoi se ka kërkuar nga inspektorët komunalë që të jenë aktivë në terren, dhe t'i monitorojnë bizneset për ngritje të çmimeve. Kryetari Lladrovci i njoftoi të pranishmit se ka kërkuar nga qytetarët që të raportojnë për keqpërdorimet me çmime dhe që gjatë blerjes të pajisen me kuponë fiskalë.

Arsim Haxhiu, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i njoftoi të pranishmit me informacionet më të reja rreth virusit dhe për gjendjen aktuale në komunën tonë, si dhe për masat e marra nga kjo drejtori duke theksuar se nuk ka elemente për panik. Një kujdes i veçantë po i kushtohet të sapoardhurve nga Italia dhe vendet potenciale.

Kryetari u ka kërkuar studentëve nga komuna jonë, që të jenë të gatshëm për të kontribuar në rast nevojë, e po ashtu që edhe policia të jetë vigjilente kundër keqbërësve të mundshëm që mund të përfitojnë nga kjo situatë.

Vendimi i fundit i Qeverisë ka krijuar edhe paqartësi rreth pushimit të njërit prind dhe me këtë rast kemi kërkuar sqarime shtesë nga qeveria për këtë çështje, tha kryetari Lladrovci.


Në fund, kryetari i njoftoi të pranishmit se Komuna e Drenasit nuk ka ndërprerë shërbimet për qytetarë. Kjo vlen deri në një njoftim tjetër.

Anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi përshëndeten masat e marra nga Komuna për këtë çështje.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Arborell Lladrovci
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime / potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramir Lladrovci   nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 13.03.2020

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.